

VENDIM
Nr. 809, datë 26.11.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.35, DATË 29.1.2014, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË
TË PËRKOZHSHME PËR VITIN 2014 NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 11, të ligjit nr.185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.35, datë 29.1.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2014, në njësitë e qeverisjes qendrore është 911 veta, sipas lidhjeve nr.1, nr.2, nr.3, nr.4, nr.5, nr.6, nr.7 dhe nr.8 që i bashkëlidhen këtij vendimi.”.

b) Pas lidhjes nr.7, bashkëlidhur vendimit në fuqi, shtohet lidhja nr.8, që i bashkëlidhet këtij vendimi, e cila detajon ndarjen e shtesës prej 4 punonjësish, të miratuar me këtë vendim, për Ministrinë e Financave.

2. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga shpenzimet korrente të miratuara në buxhetin përkatës të ministrisë për vitin 2014.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 8

Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
Ministria e Financave	4			
Aparati i Ministrisë	4	Specialiste	8 orë/ditë	15.11.2014-31.12.2014
Total punonjës me kontratë	4			